**Hapet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Evora, në Portugali, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e parë të vitit akademik 2022-2023.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa shkëmbimi për studime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Evora, në Portugali për semestrin e parë të vitit akademik 2022-2023.

https://www.uevora.pt/

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Master;

**Kohëzgjatja e bursave:**

- Master (3 muaj);

**Për më shumë informacion, referohuni në linket:**

https://www.uevora.pt/en/study/Mobility/Mobility-Programmes

https://atendimento.sac.uevora.pt/kb/faq.php?cid=43&lang=en_US

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (360 Euro);

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

**- Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

-Application form, sipas linkut: https://siiue.uevora.pt/files/anexo_informacao/284069 ;

-CV (në gjuhën angleze);
-Kopje e Pasaportës;
-Vërtetim studenti në gjuhën angleze;
-Listë notash (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Letër rekomandimi në gjuhën angleze (së paku 1);

-Diploma dhe Certifikata kualifikimesh;
-Certifikatë e gjuhës së huaj;

Për studentët që trajtohen me ndihmë ekonomime duhet edhe vërtetimi përkatës.

**Afati për aplikim: 31 Maj 2022**

Aplikimi kryhet në linkun:

https://siiue.uevora.pt/files/anexo_informacao/284069

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!